



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo – Republic of Kosovo**  
*Kuvendi – Skupština – Assembly*

---

**Legjislatura VI**  
**Sesioni pranveror**

**Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal**  
Mbledhja nr.26/2018  
Prishtinë, më 11.5.2018, në orën 10:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Sala Berisha Shala, kryetare, Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë, Hykmete Bajrami, Gani Dreshaj, Bilall Sherifi dhe Duda Balje, anëtarë.

**Munguan:** Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë, Dardan Molliqaj, Memli Krasniqi dhe Mimoza Kusari – Lila, anëtarë.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Etleva Malushaj – GDP dhe Dren Ajeti – Klubi i Prodhuesve të Kosovës dhe mediat.

**Stafi mbështetës i komisionit:** Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Veton Raci.

**Mbledhjen e kryesoi: Sala Berisha - Shala, kryetare e komisionit.**

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 26.4.2018;
3. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime për Projektligjin nr.06/L-034 për Mbrojtjen e konsumatorit;
4. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Projektligjit nr.06/L-027 për Miniera dhe minerale;
5. Të ndryshme.

*Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.*

## **1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.*

## **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 26.4.2018**

*Procesverbali i mbledhjes së datës 26.4.2018, u miratua pa vërejtje.*

## **3. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime për Projektligjin nr.06/L-034 për Mbrojtjen e konsumatorit**

**Kryetarja** i njoftoi anëtarët e komisionit se komisionet e përhershme nuk kanë dhënë ndonjë koment apo vërejtje për Projektligjin për Mbrojtjen e konsumatorit, andaj, sipas procedurës, raporti me rekomandime duhet të shkojë në lexim të dytë, në Kuvend.

*Komisioni, njëzëri, nxori këtë:*

*Përfundim*

- 1. Miratohet raporti me rekomandime i Projektligjit nr. 06/L-034 për Mbrojtjen e konsumatorit.*
- 2. Raporti me rekomandime t'i procedohet Kuvendit për lexim të dytë.*

## **4. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Projektligjit nr.06/L-027 për Miniera dhe minerale**

**Kryetarja**, tha se grupi punues ka mbajtur disa mbledhje, ku e ka shqyrtuar projektligjin në tërësi, nen për nen, dhe njëkohësisht i ka shqyrtuar edhe të gjitha amendamentet e propozuara nga Grupi Parlamentar i Listës Serbe, Ministra e Zhvillimit Ekonomik, Komision i Pavarur për Miniera dhe Minerale, Asociacioni i Komunave të Kosovës dhe të gjitha palët tjera, si organizata të biznesit, që merren me këtë fushë. Po ashtu, kemi organizuar edhe dëgjim publik. Si përfundim i kemi nxjerrë 38 (tridhjetë e tetë) amendamente, ku duhet të potencohet se amendamentet e Grupit Parlamentar të Listës Serbe, janë të gjitha, pa përkrahje.

**Gani Dreshaj**, paraqiti shqetësimet tij për mjedisin që po shkatërrohet nga një pjesë e disa kompanive që ushtrojnë veprimtari të gurëthyesve, që merren me përpunimin e zhavorrit. Ai tha se duhet të kemi kujdes më shumë sesi po e rregullojmë këtë projektligj.

**Hykmete Bajrami**, tha sa i përket mjedisit, grupi punues është munduar që Projektligjin për Miniera dhe minerale, ta harmonizojë me ligjin për ambientin. Po ashtu, propozoi që amendamentet të votohen në tërësi, në bllok, pasi që i kemi diskutuar disa herë këto çështje.

*Propozimi i znj. Hykmete Bajrami, u përkrah nga komisioni.*

*Pas debatit, komisioni, me 5 (pesë) vota për dhe 1 (një) abstenim, nxori këtë:*

*Përfundim*

1. Miratohet Raporti me amendamente i Projektligjit nr.06/L-027 për Miniera dhe minerale.
2. Raporti me amendamente i Projektligjit nr. 06/L-027 për Miniera dhe minerale, procedohet në komisionet e përhershme për vlerësim, sipas kompetencës.

Raporti me amendamente i bashkëngjitet këtij procesverballi.

### **3. Të ndryshme Çështjet vijuese.**

**Dardan Sejdiu**, e njoftoi komisionin për takimin që kanë pasur kryetarët e komisioneve me Kryetarin e Kuvendit, ku është diskutuar lidhur me përsheptimin e shqyrtimit të projektligjeve, për miratim në Kuvend. Ne, si komision, kemi shumë projektligje në procedurë, andaj për këtë, si komision, duhet që të përcaktohem se në cilën ditë, gjatë javës, mund të marrim pjesë në mbledhje, në mënyrë që mos të na dështojnë mbledhjet në mungesë të kuorumit.

**Bilall Sherifi**, tha se pajtohet që ditën e martë të caktohen mbledhjet e rregullta të komisionit, si zakonisht, që janë mbajtur deri më tani, për shkak se kemi edhe agjenda tjera në ditët tjera.

**Kryetarja**, tha se mosmbajtja e mbledhjeve ka ndodhur për shkak se e kemi ndryshuar këtë orar, për shkak të agjendave të seancave plenare dhe mungesës së deputetëve në udhëtime zyrtare.

**Hykmete Bajrami**, tha se kur të thirren mbledhjet e komisionit, të konfirmojë çdo anëtar, se a mund të marrë pjesë, me po ose jo, kjo edhe për shkak të palëve që ftohen, pra që të jemi korrektë.

*Komisioni u pajtua që mbledhjet të mbahen ditëve të marta, prej orës 11:00 dhe deputetët të konfirmojnë pjesëmarrjen e tyre në mbledhje.*

**Kryetarja** e njoftoi komisionin për vizitën që është paraparë të realizohet në Sofje të Bullgarisë, më datë 13-14 maj 2018, në “Takimin e Kryetarëve të Komisioneve për Energji të Parlamenteve të Bashkimit Evropian”, që janë tërhequr shumica e anëtarëve, për shkak të agjendave dhe kërkoi që të marrë pjesë dikush, në mënyrë që Kuvendi i Kosovës të përfaqësohet.

**Gani Dreshaj**, u paraqit vullnetar që ta përfaqësojë komisionin në këtë konferencë.

*Komisioni vendosi që deputeti, z. Gani Dreshaj, të marrë pjesë në konferencën, që do të mbahet më 13-14 maj 2018, në Sofje, në emër të komisionit, respektivisht Kuvendit të Kosovës.*

**Mbledhja përfundoi në orën 10:30.  
E përgatiti: Staf mbështetës i komisionit.**

**Kryetarja e komisionit,**  
-----  
**Sala BERISHA SHALA**